

LIGJ
Nr.9289, datë 7.10.2004

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN “PËR
TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË USHQIMEVE DELIKATE DHE PAJISJET
SPECIALE, QË PËRDOREN NË KËTO TRANSPORTE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Marrëveshjen “Për transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe pajisjet speciale, që përdoren në këto transporte”, nënshkruar në Gjenevë, më 1 shtator 1970.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4376, datë 26.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJA

**MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË USHQIMEVE DELIKATE DHE PAJISJET
SPECIALE TË PËRDORURA NË KËTO TRANSPORTE (ATP)**

Bërë në Gjenevë, më 1.9.1970

Duke dëshiruar përmirësimin e kushteve të konservimit të cilësisë së ushqimeve që prishen shpejt gjatë transportit të tyre, veçanërisht në tregtinë ndërkombëtare;

Duke konsideruar se përmirësimi i këtyre kushteve është i pritshëm të zhvillojë zgjerimin e tregut për ushqimet që prishen shpejt,

Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI 1
PAJISJET SPECIALE TRANSPORTUESE

Neni 1

Në transportimin ndërkombëtar të ushqimeve që prishen shpejt, pajisjet nuk duhet të specifikohen si pajisje të izoluar, të ngrira, të ngrira mekanikisht ose pajisje të nxehta, derisa ato të plotësojnë përcaktimet dhe standardet e vendosura në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Palët e Marrëveshjes duhet të marrin masat e nevojshme për t’u siguruar, se pajisjet e lartpërmendura në neni nr.1 të kësaj Marrëveshjeje të inspektohen dhe testohen në përputhje me

standardet e përmendura në parashikimet e shtojcës 1, në bashkëngjitjet 1, 2, 3 dhe 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Çdo pikë në Marrëveshje duhet të njohë vlefshmërinë e certifikatës së aprovimit të vendosur në përputhje me shtojcën 1, bashkëngjitjen 1, nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje nga autoriteti kompetent i palës tjetër për Marrëveshjen.

Çdo Palë Kontraktuese duhet të njohë vlefshmërinë e certifikatës së pajtimit të vendosur në përshtatje me kërkesat në shtojcën 1, bashkëngjitjet 1 dhe 2 në këtë Marrëveshje nga autoriteti kompetent dhe nga shteti që nuk është pjesëtar në kontratë.

KAPITULLI 2

PËRDORIMI I PAJISJEVE SPECIALE TRANSPORTUESE NË TRANSPORT NDËRKOMBËTAR TEK USHQIMET QË PRISHEN SHPEJT

Neni 3

1. Përgatitjet e nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje duhet të aplikohen ndaj të gjitha ngarkesave, si për ato të marra me qira dhe për ato të zotëruara vetë, të transportuara—sipas parashikimeve në pikën 2 të këtij neni — me tren, me transport rrugor apo kombinim i të dyjave, tek:

- ushqimet e ngrira shumë dhe pak, dhe tek
- ushqimet e përmendura në neni 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe nëse ato nuk janë shumë të ngrira ose të ngrira,

në qoftë se pika në të cilën ushqimet apo pajisja që i mban ato, janë ngarkuar në një tren apo mjet rrugor dhe pika në të cilën ushqimet janë apo pajisja që i mban ato është, e shkarkuar nga mjeti në 2 shtete të ndryshme, dhe pika në të cilën mallrat janë shkarkuar është vendosur në territorin e Palës Kontraktuese.

Në rast të transportit të kërkuar me një ose shumë rrugë, ndryshe nga transportimi detar i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, çdo rrugë do të konsiderohet e veçuar.

2. Përgatitjet e pikës 1 të këtij neni duhet gjithashtu të përdoren në rrugët detare në më pak se 150 km në varësi të kushteve në të cilat ushqimet janë ngarkuar në mjetin transportues të përdorur.

3. Nëse nuk plotësohen kushtet e vëna në klauzolën 1 dhe 2 të këtij neni, Palët Kontraktuese nuk kanë nevojë të aplikojnë klauzolat e vëna në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje për transportin e ushqimeve jo të destinuara për konsum njerëzor.

Neni 4

1. Për transportin e ushqimeve që prishen shpejt, të përcaktuara në shtojcat 2 dhe 3 të kësaj Marrëveshjeje, pajisja e përcaktuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje duhet të përdoret derisa temperatura të shkojë në ato nivele, ku të mos jetë nevoja e përdorimit të kësaj pajisjeje (mjetit ruajtës) për mbajtjen e temperaturave të përcaktuara në shtojcat 2 dhe 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Pra, pajisja nuk duhet të përdoret në ato momente, ku kushtet e temperaturave të caktuara në shtojcat e mësipërme do të jenë në përputhje me temperaturat e mirëmbajtjes së ngarkesës. Nëse nuk plotësohet kjo gjë, duhen marrë masat e duhura përta i përket ngrirjes,, ose ringrirjes gjatë udhëtimit apo veprime të tjera të nevojshme.

Sidoqoftë këto klauzola duhet të aplikohen vetëm për largësi, pasi ato janë të papërshtatshme me nismat në çështjet ndërkombëtare të transportimit të ngritura nga Palët Kontraktuese me cilësinë e konventës në fuqi në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje ose me cilësinë e konventës të zëvendësuar prej tyre.

2. Në qoftë se gjatë transportit nën këtë Marrëveshje, klauzolat e pikës 1 të këtij neni nuk janë plotësuar atëherë:

a) ushqimet nuk mund të futen në konsum në territorin e Palës Kontraktuese pas përfundimit të transportimit; vetëm, nëse autoritetet kompetente të kësaj Pale e shohin si të përshtatshme me kërkesat e shëndetit publik, për të autorizuar një konsum të tillë dhe vetëm nën këto kushte, pasi autoritetet të vendosin autorizimin ku kërkesat plotësohen;

b) çdo Palë Kontraktuese mundet, për arsye të shëndetit publik ose zooprofilaksisë dhe përta

kohë ngarkesa të jetë në mospërputhje me rregullat ndërkombëtare të përmendura në fjalinë e fundit të pikës 1 të këtij neni, të ndalojnë hyrjen e ushqimeve në këtë territor ose të bëjnë që hyrja e këtyre mallrave t'i nënshtrohet kushteve të tilla që të mos lejohet hyrja e tyre.

3. Përshtatja me klauzolat e pikës 1 të këtij neni duhet t'i kërkohej transportuesit të marra me qira apo të kërkuara vetëm për një rrugë, dhe derisa ato të kenë marrë masa që të sigurojnë shërbimet e menduara si të përshtatshme për të siguruar të tillë pajtim dhe nëse ky pajtim varet nga ekzekutimi i këtyre shërbimeve.

Nëse persona të tjerë, qofshin individë apo bashkëpunëtorë, të kenë marrë përsipër të kryejnë shërbime të këtij lloji, duke parashikuar garantimin në përshtatje me këtë marrëveshje, atyre duhet t'u kërkohej garantim i tillë sa më i gjatë në varësi të performancës së shërbimit që ata marrin përsipër të sigurojnë ose të gjejnë.

4. Gjatë transportit, i cili është subjekt i klauzolave të kësaj Marrëveshjeje dhe për të cilin ngarkesa është konstatuar në territorin e një Pale, përgjegjësia në përputhje me kërkesat e pikës 1 të këtij neni do të jetë subjekt i klauzolave të pikës 3 të këtij neni,

- në rast të transportit me qira ose të kërkuar, me personin qoftë individ ose bashkëpronësi, i cili është marrës ngarkese sipas dokumenteve të transportit ose, në mungesë të një dokumenti transporti, me personin, qoftë individ apo bashkëpronësi, i cili ka hyrë në kontratë të transportit me transportuesin;

- në rastet e tjera me personin, qoftë individuale apo bashkëpronësi kryhet transportimi.

KAPITULLI 3 PËRGATITJE TË NDRYSHME

Neni 5

Kërkesat për këtë Marrëveshje nuk duhet të aplikohen në kontenierë rrugorë, pa transportim mallrash, kur transportimi është parashikuar të kryhet nëpërmjet rrugës detare ndryshe nga mënyra e përcaktuar në nenin 3 pika 2 në këtë Marrëveshje.

Neni 6

1. Secila Palë Kontraktuese duhet të marrë masat përkatëse për të siguruar inspektimin e klauzolave të vendosura në këtë Marrëveshje. Administratat kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të kalojnë njëra-tjetrën të informuara rreth masave të përgjithshme të marra mbi këtë qëllim.

2. Nëse një prej Palëve Kontraktuese zbulon ndonjë shkelje në Marrëveshje, kryer nga një person me qëndrim në territorin e Palës tjetër apo ushtron ndonjë masë ndëshkuese, administrata e palës së parë duhet të njoftojë administratën e palës tjetër për shkeljen e ndodhur dhe masën ndëshkuese të vendosur.

Neni 7

Palët Kontraktuese të drejtën për të hyrë në Marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe për shkak të ruajtjes së klauzolave të vendosura ndaj përdorimit të pajisjeve speciale dhe klauzolave për temperatura në të cilën disa lloje ushqimesh duhet të mbahen gjatë transportit, më shumë veçanërisht prej kushteve klimaterike, të jenë më rigorozë sesa janë të përshkruara në këtë Marrëveshje.

Këto klauzola duhet të aplikohen vetëm në rast të transportit ndërkombëtar midis Palëve Kontraktuese, të cilat kanë përfunduar marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe referuar në këtë paragraf.

Të tilla kontrata duhet t'i paraqiten Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (OKB), i cili duhet t'u komunikojë atyre, Palëve Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje, të cilët ende nuk janë nënshkrues mbi marrëveshjet e lartpërmendura.

Neni 8

Moskryerja e vëzhgimit të kësaj Marrëveshjeje nuk duhet të ketë ndikim as në qenësinë as në vlefshmërinë e kontratave të arrira për qëllim të rendimentit të transportit.

KAPITULLI 4 PËRGATITJET PËRFUNDIMTARE

Neni 9

1. Shtetet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën dhe shtetet e pranura në Komision nën rolin e këshilltarit të mundshëm të përcaktuar nën nenin 8 në kushtet e referencës së Komisionit mund të bëhen Palë Kontraktuese në këtë Marrëveshje,

- a) duke e firmosur atë;
- b) duke e ratifikuar atë pasi ta kenë firmosur;
- c) duke e miratuar atë.

2. Shtetet të cilat mund të marrin pjesë në veprimtari të tilla të Komisionit Ekonomik për Europën nën nenin 11 të kushteve në lidhje me Komisionin mund të bëhen Palë Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje duke e pranuar atë pasi të ketë hyrë në përdorim.

3. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 31 maj 1971, përfshirë këtë datë. Pas kësaj, do të jetë e hapur për pranim.

Ratifikimi ose pranimi duhet të shoqërohet me depozitimin e një instrumenti nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 10

1. Çdo shtet mundet që në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje pa rezervim, si në rastin e ratifikimit ose të pranimit, ose në çdo kohë më pas të deklarojë nëpërmjet lajmërimit adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara se Marrëveshja nuk përdoret për transport në çdo territor ose në një territor të veçantë që gjendet jashtë Europës.

Nëse lajmërimi i mësipërm është kryer pas hyrjes në veprim të Marrëveshjes për respekt të shtetit lajmërues duhet, që pas 90 ditësh nga data në të cilën Sekretari i Përgjithshëm ka marrë lajmërim, të pushojë së vepruari transportin në territorin ose territoret e përmendura në lajmërim.

2. Çdo shtet i cili ka bërë një deklaratë nën pikën 1 të këtij neni mundet, që në çdo kohë të mëvonshme, të deklarojë përmes lajmërimit adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, se Marrëveshja do të jetë e vlefshme (do të hyjë në veprim fjalë për fjalë) për transportin e realizuar në një territor të përmendur në lajmërimin e bërë në pikën 1 të këtij neni dhe Marrëveshja të bëhet e vlefshme për transportet në atë territor 180 ditë pas datës në të cilën Sekretari i Përgjithshëm ka marrë lajmërimin.

Neni 11

1. Kjo Marrëveshje duhet të hyjë në veprim një vit pasi pesë nga shtetet e përmendura në nenin 9, pika 1 ta kenë nënshkruar atë pa rezerva, pasi ose ta kenë ratifikuar, apo të kenë depozituar instrumentet e ratifikimit apo të hyrjes në fuqi.

2. Duke respektuar çdo shtet i cili ratifikon ose pranon të hyjë, kjo Marrëveshje pasi 5 shtetet ta kenë financuar atë pa rezerva apo ta kenë ratifikuar ose të kenë shtuar dokumentet e tyre të ratifikimit apo pranimit, kjo Marrëveshje duhet të hyjë në veprim një vit pasi shtetet e përmendura të kenë lëshuar instrumentet e tyre të ratifikimit apo pranimit.

Neni 12

1. Çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke e dhënë lajmin e denoncimit te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi duhet të bëhet 15 muaj pas datës në të cilën Sekretari i Përgjithshëm ka marrë lajmërimin për denoncim.

Neni 13

Kjo Marrëveshje duhet të pushojë së vepruari, në qoftë se numri i Palëve Kontraktuese është më i paktë se pesë, përmes një periudhe 12-muajshe dhe të vazhdueshme pas hyrjes së saj në veprim.

Neni 14

1. Çdo shtet mundet që pasi ta ketë nënshkruar pa rezerva, ratifikuar ose depozituar një mjet ratifikues ose ta ketë pranuar këtë Marrëveshje; deklarohet nga njoftimi adresuar te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara që kjo Marrëveshje do të jetë e zbatueshme te të gjitha ose në çdo territor, për marrëdhënie ndërkombëtare, për të cilat ai shtet është përgjegjës.

Kjo Marrëveshje duhet të zbatohet në territorin apo territoret e vendosura në lajmërim 90 ditë pas vënies në dijeni të Sekretarit të Përgjithshëm ose nëse atë ditë Marrëveshja nuk ka hyrë në veprim, pas hyrjes së saj në veprim.

2. Çdo shtet i cili ka bërë një deklaratë sipas pikës 1 të këtij neni, duke e bërë të vlefshme dhe të zbatueshme këtë Marrëveshje në një territor në të cilin marrëdhëniet ndërkombëtare janë përgjegjëse, që mund të denoncojnë këtë Marrëveshje veçmas duke qenë në konformizëm me nenin 12.

Neni 15

1. Çdo kundërshtim midis dy ose më shumë Palëve përsa i përket interpretimit apo zbatimit të kësaj Marrëveshjeje duhet të ndreqet me anën e negocimit midis tyre sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Çdo kundërshti e cila nuk është sheshuar përmes negociatave duhet të zgjidhet në bazë të arbitrazhit, në qoftë se një nga Palët e kërkon këtë gjë, zgjedh dhe arbitrat nga vetë Palët Kontraktuese. Nëse brenda tre muajve nga data e kërimit për gjykim, Palët janë të pamundura të zgjedhin gjykatësin, secila nga këto Palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të zgjedhë një gjykatës të vetëm për të zgjidhur këtë çështje.

3. Vendimi i gjyqtarit të përmendur më sipër do të jetë detyrues për palët në konflikt.

Neni 16

1. Çdo shtet mundet, që në kohën e firmosjes, ratifikimit apo pranimit të kësaj Marrëveshjeje, të deklarojë se ai nuk e konsideron veten të aftë të kufizohet në caqet e vëna në nenin 15 pika 2 dhe 3.

Pala tjetër Kontraktuese nuk do të kufizohet brenda kufijve të mësipërm, duke respektuar çdo Palë që ka ndërmarrë një hap të tillë.

2. Çdo Palë Kontraktuese, e cila ka ndërmarrë një hap të tillë nën pikën 1 të këtij neni mundet që në çdo kohë ta hedhë poshtë këtë kufizim përmes njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Përveç lëshimit të lajmit të përshkruar në pikën 1 të këtij neni asnjë lajm apo lëshim (mundësi apo veçori për të mbajtur një qëndrim të caktuar ndaj një çështjeje, në këtë rast pika 1) tjetër nuk është i lejuar në këtë Marrëveshje.

Neni 17

1. Pasi kjo Marrëveshje të jetë në përdorim prej tre vitesh, çdo Palë Kontraktuese mundet, përmes lajmërimit adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, të kërkojë që të mbahet një konferencë me qëllim për të rishikuar Marrëveshjen.

Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese të kërkesës dhe më pas një konferencë rishikimi do të mbahet nga Sekretari i Përgjithshëm nëse, brenda një periudhe prej 4 muajsh do të jetë lajmërimi i dërguar Sekretarit të Përgjithshëm, jo më pak se 1/3 e Palëve Kontraktuese japin miratimin e tyre për kërkesën.

2. Nëse një konferencë është mbajtur në zbatim të pikës 1 sipas këtij neni, Sekretari i Përgjithshëm do të këshillojë të tëra palët dhe do t'i ftojë ato të shtrojnë brenda një periudhe kohë prej 3 muajsh, propozimet për të cilat ata, dëshirojnë që konferenca t'i marrë në shqyrtim.

Sekretari i Përgjithshëm duhet të qarkullojë axhendën e përkohshme për konferencën, së bashku me tekstin e këtyre propozimeve, për të gjitha Palët Kontraktuese jo më pak se 3 muaj para datës në të cilën konferenca do të mbahet.

3. Sekretari i Përgjithshëm duhet të ftojë në konferencën e mbajtur të lartpërmendur të tëra vendet e përmendura në nenin 9 pika 1 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha vendet të cilat kanë qenë Palë Kontraktuese të thëna në nenin 9 pika 2.

Neni 18

1. Ndonjë Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente për këtë Marrëveshje. Teksti i ndonjë amendamenti të propozuar duhet të komunikohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili do ta komunikojë atë te secila Palë Kontraktuese, dhe do ta sjellë atë lajmërim në të gjitha shtetet e tjera referuar në nenin 9 pika 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Sekretari i Përgjithshëm mund të propozojë gjithashtu amendamente të kësaj Marrëveshjeje ose tek anekset e saj, të cilat janë transmetuar tek ai nga pala punonjëse mbi transportin e ushqimeve delikate të komitetit të transportit me shtrirje brenda vendit për Komisionin Ekonomik për Europën.

2. Brenda një periudhe 6-mujore duke ndjekur datën mbi të cilën amendamenti i propozuar është komunikuar nga Sekretari i Përgjithshëm, ndonjë Palë Kontraktuese mund të informojë Sekretarin e Përgjithshëm,

a) se ajo ka një vërejtje të amendamentit të propozuar ose

b) sadoqë nënkuptohet pranimi i propozimit, kushtet e nevojshme për të tilla miratime nuk janë përmbushur ende në vendin e kësaj Pale.

3. Në qoftë se një Palë Kontraktuese i dërgon Sekretarit të Përgjithshëm një njoftim me kusht që në pikën 2 (b) të këtij neni, ajo mundet, sa kohë që nuk ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për miratimin e saj, duke parashtruar një kundërshtim tek amendamenti i propozuar brenda një periudhe prej 9 muajsh pas mbarimit të periudhës 6-mujore rekomanduar për respekt të komunikimit fillestar.

4. Në qoftë se një vërejtje tek amendamenti i propozuar është shpallur në pajtim me kushtet e 2 dhe 3 të këtij neni, amendamenti s' duhet konsideruar si i pranuar dhe duhet të jetë pa fuqi vepruese.

5. Në qoftë se s' ka vërejtje tek amendamenti i propozuar dhe ka qenë deklaruar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, amendamenti duhet të konsiderohet i pranuar mbi datën e caktuar poshtë:

a) në qoftë se ndonjë Palë Kontraktuese s' ka dërguar komunikim te Sekretari i Përgjithshëm, në përputhje me pikën 2 (b) të këtij neni, skadimi i periudhës 6-mujore referohet te pika 2 e këtij neni;

b) në qoftë se të paktën një Palë Kontraktuese ka dërguar një komunikim te Sekretari i Përgjithshëm, në përputhje me pikën 2 (b) të këtij neni, si më të hershme duhet të jenë dy datat në vijim:

- data për të cilën të tëra Palët Kontraktuese kanë dërguar komunikime të tilla dhe e kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për miratim nga ana e tyre të amendamentit të propozuar, por kushti kufizues do të jetë që nëse të tëra miratimet ishin shpallur para skadimit të periudhës 6-mujore referuar në pikën 2 të këtij neni, data duhet të jetë e skadimit të kësaj periudhe;

- data e skadimit të periudhës 9-mujore, referuar në pikën 3 të këtij neni.

6. Ndonjë amendament i konsideruar të pranohet, duhet të hyjë në fuqi 6 muaj pas datës në të cilën ai qe menduar të pranohej.

7. Sekretari i Përgjithshëm duhet, sa më shpejt të jetë e mundur, të informojë të tëra Palët Kontraktuese nëse një ose më shumë nga ato i kanë dërguar atij një komunikim sipas pikës 2 (b) të këtij neni.

Një ose më shumë Palë Kontraktuese i kanë dërguar atij një komunikim të tillë, ai duhet të njoftojë më vonë të tëra palët, nëse pala apo palët që kanë dërguar komunikimin shtrojnë vërejtje apo pranojnë amendamentin e propozuar.

8. Pavarësisht se procedura e amendamentit është vënë poshtë në pikat 1 deri në 16 të këtij neni, anekset dhe shtojcat te kjo Marrëveshje mund të modifikohen me marrëveshjen ndërmjet administratave përgjegjëse për të gjitha Palët Kontraktuese.

Në qoftë se administrata e një Pale ka shpallur që nën ligjin e saj kombëtar marrëveshja e saj është e mundshme mbi autorizimin special ose mbi miratimin e një trupi legjislativ, miratimi i Palës

Kontraktuese e interesuar që modifikimi i një aneksi nuk duhet menduar të jepet derisa Pala Kontraktuese ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm që autorizimi i nevojshëm apo miratimi është fituar.

Kjo Marrëveshje ndërmjet administratave përgjegjëse mund të sigurojë që, gjatë një periudhe kalimtare, anekset e vjetra do të mbesin në fuqi, pjesërisht apo krejtësisht, në harmoni me anekset e reja. Sekretari i Përgjithshëm duhet të caktojë datën e hyrjes në fuqi të teksteve të reja, rezultate nga modifikime të tilla.

Neni 19

Përveç komunikimit të shpalljeve në paragrafët 17 dhe 18 të kësaj Marrëveshjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të njoftojë shtetet e përmendura në nenin 9 pika 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe shtetet të cilat janë bërë Palë Kontraktuese nën nenin 9 pika 2 të:

- a) nënshkrimeve, ratifikimeve dhe pëlqimit nën nenin 9;
- b) datave të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në pajtim me nenin 11;
- c) denoncimeve nën nenin 12;
- d) përfundimit të kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 13;
- e) shpalljeve të marra nën paragrafët 10 dhe 14;
- f) deklarimeve dhe njoftimeve të marra nën nenin 16 pika 1 dhe 2;
- g) hyrjes në fuqi të çdo amendamenti sipas nenit 18.

Neni 20

Pas 31 majit 1971, origjinali i kësaj Marrëveshjeje do të jetë i depozituar në Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e cila duhet t'i paraqesë kopje të vërteta të certifikatave çdo shteti të përmendur në nenin 9 pika 1 dhe 2 në këtë Marrëveshje.

Në prani të dëshmitarëve, nënshkruesit, duke qenë plotësisht të autorizuar kanë firmosur këtë Marrëveshje.

E përfunduar në Gjenevë, më 1 shtator 1970, në një kopje të vetme, në anglisht, frëngjisht dhe rusisht, me tre tekste plotësisht autentike.

SHTOJCA 1

PËRCAKTIMET DHE STANDARDET PËR PAJISJET SPECIALE ¹ NË USHQIMET DELIKATE

Pajisja e izoluar. Pajisja, trupi² i së cilës është ndërtuar me mure, dyer, dysheme dhe tavan të izoluar, në të cilën nxehtësia varion midis brendësisë dhe pjesës së jashtme të trupit mund të jetë kaq e kufizuar sa koeficienti i përgjithshëm i transmetimit të nxehtësisë (k), është i tillë që pajisja është caktuar në njërën ose tjetrën kategori të mëposhtme:

IN = Pajisje normalisht e izoluar - e karakterizuar nga një koeficient $k \leq 0.70 \text{ W/m}^2 \text{ K}$

IR = Pajisje e izoluar së tepërmi e karakterizuar nga: - një koeficient $k \leq 0.40 \text{ W/m}^2 \text{ K}$

- mure me një trashësi të paktën 45 mm për pajisjen transportuese dhe gjërësi më të madhe se 2.50 m.

Sidoqoftë, kushti i dytë nuk është i nevojshëm për pajisjen transportuese menduar para datës së hyrjes në veprim të këtij përmirësimi³ dhe e ndërtuar para kësaj date ose gjatë një periudhe kohore pas tre vitesh nga kjo datë.

Përcaktimi i koeficientit k dhe një përshkrim të metodës së përdorur në matjen e tij është dhënë në bashkëngjitjen 2 të kësaj shtojce.

2. Pajisja ftohëse. Pajisja e izoluar, e cila, duke përdorur një burim të ftohtë (akull natyror, me

¹ Vagonat, kamionet, rimorkio, gjysmë-rimorkiot, kontenieret dhe pajisje të tjera të ngjashme.

² Në rastin e pajisjeve cisternë, fjala "shasi" nënkupton në këtë rast vetë cisternën.

³ Data e futjes në fuqi për këtë përmirësim është 15. 5. 1991.

ose pa kripë; pllaka eutetike; akull i thatë, me ose pa kontroll sublim; gaze të lëngët, me ose pa kontroll avullimi etj.), sesa një njësi mekanike ose absorbuese është në gjendje që me një temperaturë të jashtme +30°C, të ulë temperaturën brenda trupit dhe ta mbajë atë në këto nivele:

- 7 °C maksimumi në rastin e klasit A;
- 10 °C maksimumi në rastin e klasit B;
- 20 °C maksimumi në rastin e klasit C;
- 0 °C maksimumi në rastin e klasit D,

me ndihmën e ftohësve të përshtatshëm dhe pajisjeve. Pajisje të tilla duhet të përfshijnë një ose më shumë ndarje, konteinerë apo depozita për ftohësit. Ndarjet e përmendura, konteinerët apo depozitat duhet:

Të jenë të mundshme të mbushen apo rimbushen nga jashtë;

Të kenë një kapacitet konform parashikimeve të shtojcës 1, bashkëngjites 2, pikës 34.

Koeficienti k i njësisë së klaseve B dhe C duhet në çdo rast të jetë i barabartë ose më i vogël se 0.40 W/m², K.

3. Pajisje të ftohura mekanikisht. Pajisjet e izoluara si të përshtatshme me ftohësin e vet apo dhe të shoqëruara bashkë me njësitë e pajisjes transportuese duhet të jenë në gjendje (njësi mekanike shtypëse, njësi “thithëse” etj.) pune. Pajisja duhet të mundësoj, me një temperaturë të jashtme prej +30 °C të ulë temperaturën brenda trupit të zbrazur në një temperaturë si më poshtë dhe ta mbajë në këto kufij:

Në rastin e klaseve A, B dhe C, çdo vlerë konstante e dëshiruar t_1 në përputhje me standardet e përcaktuara më poshtë për të tre klasat:

Klasi A. Pajisja ftohëse mekanike e shoqëruar me një pajisje ftohëse të tillë që të mbajë t_1 midis +12 °C dhe 0 °C.

Klasi B. Pajisje me ftohës mekanikë të shoqëruar me pajisje ftohëse të tillë që të mbajë t_1 midis -10 °C dhe +12 °C.

Klasi C. Pajisje me ftohës mekanikë të shoqëruar me pajisje ftohëse të tillë që të mbajë t_1 midis -20 °C dhe +12 °C.

Në rastet e klaseve D, E dhe F një vlerë praktike konstante e t_1 në përputhje me standardet është e përcaktuar për të tre klasat:

Klasi D. Pajisje me ftohës mekanik e shoqëruar me një pajisje ftohëse të tillë që të mbajë t_1 të barabartë ose më të vogël se 0 °C.

Klasi E. Pajisja me ftohës mekanik me një pajisje të tillë që t_1 më i vogël ose baras se -10 °C.

Klasi F. Pajisje me ftohës mekanik me ftohje të tillë që $t_1 \leq -20$ °C. Koeficienti k i pajisjes për klasat B, C, E dhe F duhet që në çdo rast të jetë më i vogël ose baras se 0.40 W/m² K.

4. Pajisja nxehtë. Është një pajisje e shoqëruar me një mjet prodhues nxehtësie, i cili është në gjendje të rrisë temperaturën brenda trupit të zbrazur dhe ta mbajë atë temperaturë brenda një periudhe prej 12 orësh pa një ripërtëritje të pajisjes në një vlerë konstante jo më pak se +12 °C ku temperatura jashtë ambientit të trupit është e treguar më poshtë për dy nga klasat:

Klasi A. Pajisja ngrohëse për përdorim ku temperatura jashtë është -10 °C;

Klasi B. Pajisja ngrohëse për përdorim ku temperatura jashtë është -20 °C.

Koeficienti k i pajisjes së klasit B duhet që për çdo rast të jetë më i vogël apo baras 0.40 W/m² K.

5. Parashikimet e ndërmjetme. Për një periudhë trevjeçare pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me parashikimet e nenit 11 pika 1, atëherë koeficienti i përgjithshëm i nxehtësisë mundet, në rastin e pajisjes tashmë në funksionim në këtë kohë, të jetë i barabartë ose më i vogël se:

0.90 W/m² K në rastin e pajisjes së izoluar në kategorinë IN, e pajisjes ftohëse të klasit A, të të gjitha pajisjeve ftohëse dhe pajisjes ngrohëse në klasin A dhe

0.60 W/m² K në rastin e pajisjes ftohëse në klasat B, C dhe pajisjes ngrohëse në klasin B.

Për më tepër, pas një periudhe trevjeçare të përshkruar në pikën e parë të këtij neni dhe pasi pajisja është përfundimisht e nxjerrë nga përdorimi, koeficienti k i pajisjes ftohëse mekanike për klasat B, C, E dhe F mund të jetë më i vogël ose baras 0.70 W/m² K.

Këto parashikime të ndërmjetme, sidoqoftë, nuk duhet të parambyllin aplikimin për çdo rregullim strikt të vendosur nga shtetet për pajisjet e regjistruara në territorin e tyre.

ANEKSI 1, SHTOJCA 1

PËRGATITJET NË LIDHJE ME KONTROLLIN E PAJISJEVE TË IZOLUARA, ME FTOHJE MEKANIKE, RIFTOHJE OSE ME KONTROLLIN E PAJISJEVE PËR NGROHJE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET.

1. Kontrollat, në përputhje me standardet të përshkruara në këtë aneks, duhet të bëhen:

- a) para se pajisja të vihet në punë;
- b) periodikisht, të paktën njëherë në çdo gjashtë vjet;
- c) kurdoherë që kërkohet nga autoriteti përgjegjës.

Përveçse në rastet e paraqitura në shtojcën 2, neni 29 dhe 49 të këtij aneksi, kontrollat duhet të bëhen në një stacion testues të projektuar apo të miratuar nga autoriteti përgjegjës i vendit, në të cilin pajisja është regjistruar, përderisa, në rastin e kontrollit të përcaktuar në pikën (a) sipër, një kontroll është ndërmarrë tashmë mbi vetë pajisjen ose në prototipin e tij në një situatë testuese të projektuar apo miratuar nga autoriteti përgjegjës i vendit në të cilin kjo pajisje është prodhuar.

2. a) Pajisja e re dhe tipi i caktuar i prodhuar në seri mund të miratohet nga testimi i një njësie të atij lloji tipi. Në qoftë se njësia e testuar plotëson kërkesat e dhura për klasën së cilës i përket, testi i miratuar duhet të shihet si një dëshmi miratuese e atij lloji. Kjo dëshmi do të skadojë në fund të periudhës 6-vjeçare.

b) Autoriteti përgjegjës duhet të marrë hapa për të verifikuar se prodhimi i njësisë është në përputhje me tipin e miratuar. Për këtë qëllim ai mund të kontrollohet përmes testimit të njësisë të ngjashme të marra rastësisht nga seritë e prodhimit.

c) Një njësi nuk duhet të shihet si qenia e të njëjtit tip, derisa njësia e testuar të plotësojë minimumin e kushteve të mësipërme:

i) Në qoftë se ajo është një pajisje e izoluar, në çdo rast pajisja mund të jetë e izoluar, me ftohje, me ftohje mekanike ose pajisje ngrohëse;

konstrukti mund të jetë i krahasueshëm dhe në veçanti materiale izoluese dhe metoda e izolimit duhet të jetë identike;

trashësia e materialit izolues duhet të jetë jo më pak se pajisja e marrë si referencë;

përputhjet e brendshme duhet të jenë identike ose të thjeshtuara;

numri i dyerve dhe i dritareve ose hapjeve të tjera duhet të jetë i njëjtë ose më pak;

sipërfaqja e brendshme e trupit nuk duhet të jetë më shumë se 20% më e vogël apo më e madhe.

ii) Në qoftë se është pajisje ftohëse për çdo rast duhet të plotësojë këto kushte:

kushtet e vëna në pikën (i) duhet të plotësohen;

në brendësi pajisjet e ventilimit duhet të jenë të krahasueshme;

burimi i të ftohtit duhet të jetë identik;

rezerva e të ftohtit për njësi të sipërfaqes së brendshme duhet të jetë më e madhe ose e barabartë.

iii) Në qoftë se është pajisje me ftohje mekanike, atëherë duhet të plotësojë:

a) pajisje me ftohje mekanike;

kushtet e vendosura në pikën (i) sipër duhet të plotësohen;

efektiviteti i kapacitetit ftohës ose përdorimi i ftohjes, i ftohjes mekanike për njësi të sipërfaqes së brendshme nën të njëjtat kushte temperature duhet të jenë më të mëdha ose të barabarta;

ose (b) pajisja e izoluar në të cilën është menduar, që në një datë të mëvonshme, t'i bashkëngjitet një njësi ftohëse mekanike, dhe i cili është plotësuar në çdo detaj, por me një njësi ftohëse të çmontueshme dhe pjesa hapëse e mbushur, përgjatë matjes së koeficientit K, me panele të mbërthyera ngushtë mbi trashësinë e përgjithshme të trupit me një tip izolues, siç është vepruar në murin përballë. Në çdo rast:

kushtet e vendosura në pikën (i) të mësipërme duhet të plotësohen

dhe kapaciteti efektiv ftohës, i ftohësit mekanik i bashkëngjitet pajisjes ftohëse, dhe duhet të jetë sipas përcaktimeve në aneksin 1, shtojca 2, neni 41.

iv) Në qoftë se është një pajisje ngrohëse, në çdo rast pajisja në fjalë mund të jetë e izoluar ose

pajisje e ngrohur:

kushtet e vëna në pikën (i) sipër duhet të plotësohen;

burimi i nxehtësisë duhet të jetë identik;

kapaciteti i aplikimit të nxehtësisë për njësi sipërfaqeje duhet të jetë më i madh ose baras.

d) Në qoftë se në vazhdimin e një periudhe 6-vjeçare, seritë e prodhimit kalojnë 100 njësitë, autoriteti përgjegjës duhet të përcaktojë përqindjen e njësive për t'u testuar.

3. Metodatat dhe procedurat e përdorura në kontrollin për përputhje me standardet janë përshkruar në shtojcën 2 të këtij aneksi.

4. Një dëshmi përputhëse me standardet duhet të lëshohet nga autoriteti përgjegjës i vendit në të cilin është regjistruar pajisja sipas modelit të ofruar nga shtojca 3 e këtij aneksi.

Në rastin e pajisjes së transferuar në një vend tjetër, i cili është Palë Kontraktuese në ATP, ajo duhet shoqëruar me dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që autoriteti përgjegjës në të cilin pajisja është për t'u regjistruar duhet të nxjerrë një dëshmi ATP.

a) në të tëra rastet, raporti testues i vetë pajisjes ose në rastet e pajisjes së prodhuar në seri të një nga zgjedhjet e këtij grupi serie;

b) në të gjitha rastet, dëshmia ATP është lëshuar nga autoriteti përgjegjës i vendit prodhues ose, për pajisjet në shërbim, nga autoriteti përgjegjës i vendit të regjistrimit, kjo dëshmi do të trajtohet si një dëshmi paraprake e vlefshme, në qoftë se është e nevojshme, për tre muaj;

c) në rastet e pajisjes së prodhuar në mënyrë seri, përcaktimet teknike të pajisjes për t'u pajisur me dëshmi – ky përcaktim duhet të mbulojë të njëjtat kërkesa si ato të përshkruara në faqet ku flitej për pajisje të cilat do të paraqiten në raportin testues.

Në rastin e pajisjes së transferuar pasi ka qenë në përdorim, pajisja mund të jetë subjekt i një inspektimi vizual për të konfirmuar përkatësinë e saj përpara se autoriteti përgjegjës i vendit në të cilin është për t'u regjistruar të paraqesë një dëshmi shoqëruese.

Dëshmia ose një kopje e origjinalit duhet t'i bashkëngjitet pajisjes së transportit dhe të jetë prodhuar ngado që kërkohet nga autoritetet kontrolluese. Sidoqoftë, në qoftë se pllaka e dëshmisë në shtojcën 3 të këtij aneksi është shoqëruar me pajisjen, pllaka e përmendur duhet të njihet si ekuivalente e dëshmisë ATP.

Pllaka e dëshmisë e sipërpërmendur duhet të hiqet menjëherë sapo pajisja e fikur të përputhet me standardet e paraqitura në këtë aneks. Në qoftë se pajisja nuk mund të projektohet si përkatëse e një kategorie apo klase përveç vlerës së klauzolave transite të përmendura në nenin 5 të këtij aneksi, vlefshmëria e dëshmisë e lëshuar për pajisje të këtij lloji duhet të kufizohet për periudhën e dhënë në klauzolat transite.

5. Shenjat dalluese dhe të veçanta duhet t'i bashkëngjiten pajisjes në përputhje me parashikimet e shtojcës 4 të këtij aneksi. Ato duhet të hiqen menjëherë sapo pajisja të rreshtë së punuari në përputhje me standardet e dhëna në këtë aneks.

6. Trupat izolues të pajisjeve transportuese “të izoluar”, “ftohëse”, “me ftohje mekanike” apo me “ngrohës” dhe pajisjet ndihmëse të tyre termale, duhet që të gjitha të mbajnë shenja dalluese të shoqëruara nga prodhuesi dhe të përfshijnë të paktën këto veçanti si më poshtë:

Vendin e prodhuesit apo letrat e përdorura në trafikun rrugor ndërkombëtar;

Emrin e prodhuesit apo kompanisë;

Modeli (me pamje ose të dhëna me fjalë);

Numri i serisë;

Muaji dhe viti i prodhimit.

ANEKSI 1, SHTOJCA 2

METODAT DHE PROCEDURAT PËR MATJEN DHE KONTROLLIN E KAPACITETIT IZOLUES DHE EFIÇENCËN E PAJISJEVE SPECIALE FTOHËSE OSE NGROHËSE PËR TRANSPORTIN E USHQIMEVE QË PRISHEN SHPEJT

A. Parimet e përgjithshme dhe përcaktimet.

1. Koeficienti K. Koeficienti i përgjithshëm i transmetimit të nxehtësisë (koeficienti K) i cili

tregon kapacitetin izolues të pajisjes është përcaktuar nga formula e mëposhtme:

$$K = W / (S \cdot \Delta\theta)$$

Ku W është kapaciteti termik i kërkuar në sipërfaqen (S) mesatare të trupit që të mbajë diferencën absolute $\Delta\theta$ midis temperaturës mesatare të brendshme θ_i dhe temperaturës mesatare të jashtme θ_e , gjatë punës së vazhdueshme, ku temperatura e jashtme θ_e është konstante.

2. Sipërfaqja mesatare S e trupit është mesatarja gjeometrike e sipërfaqes së brendshme S_i dhe sipërfaqes së jashtme S_e të trupit:

$$S = \sqrt{S_i \cdot S_e}$$

Në përcaktimin e dy sipërfaqeve S_i dhe S_e , karakteristikat e strukturave dhe çrregullsitë sipërfaqësore të trupit, të tilla si mbyllurat, harqe rrotullimi apo diçka e ngjashme duhet të merren në shqyrtim dhe duhet përmes pikave të përshtatshme të përshkruara në testin raportues; sidoqoftë në qoftë se trupi është i mbuluar me fletë metalike të gërryera, sipërfaqja që do të merret në shqyrtim duhet të jetë sipërfaqja e planit të zënë dhe jo ajo e sipërfaqes së konsumuar.

3. Në rastet e trupave paralelepiped, temperatura mesatare e brendshme e trupit (θ_i) është mesatare aritmetike e temperaturës e matur 10 cm nga muret në 12 pikat e mëposhtme:

a) tetë këndet e brendshme të trupit dhe

b) qendrat e katër faqeve të brendshme që kanë sipërfaqe më të madhe.

Në qoftë se trupi nuk është paralelepiped, 12 pikat e matjes duhet të shpërndahen sa më uniforme që të jetë e mundur, duke pasur parasysh formën e trupit.

Në rastin e trupave paralelepiped, temperatura mesatare e jashtme e trupit (θ_e) është mesatarja aritmetike e temperaturave të matura 10 cm nga muret në 12 pikat e mëposhtme:

a) tetë këndet e brendshme të trupit;

b) qendrat e katër faqeve që kanë sipërfaqe më të madhe.

Në qoftë se trupi nuk është paralelepiped, 12 pikat e matura duhet të shpërndahen sa më uniforme që të jetë e mundur, duke pasur parasysh formën e trupit.

5. Temperatura mesatare e mureve të trupit është mesatarja aritmetike e temperaturës mesatare të jashtme dhe temperaturës mesatare të brendshme të trupit:

$$(\theta_e + \theta_i) / 2$$

6. Temperaturat mesatare të jashtme dhe temperaturat mesatare të brendshme të trupit, të marra për një periudhë të qëndrueshme jo më pak se 12 orë, nuk duhet të vonojnë më tepër se intervali $\pm 0.3^\circ\text{C}$, dhe këto temperatura nuk duhet të vonojnë më tepër se $\pm 1.0^\circ\text{C}$ gjatë 6 orëve të ardhshme.

Diferenca ndërmjet kapacitetit termik matur mbi dy perioda në më pak se tre orë të fillimit dhe fundi i periodës së gjendjes të qëndrueshme, duhet të jetë të paktën 3 %, i ndarë në të paktën 6 orë.

Kjo vlerë mesatare e temperaturave dhe kapacitetit termik gjatë një periudhe kohe prej të paktën 6 orësh do të përdoret në llogaritjen e koeficientit K .

Temperaturat mesatare të brendshme dhe të jashtme në fund dhe fillim ndryshojnë më tepër se 0.2°C .

B. Kapaciteti kohor i pajisjes.

Procedurat për matjen e koeficientit K

a) Pajisje të ndryshme nga kontenierët me lëndë ushqimore të lëngshme.

7. Kapaciteti izolues duhet të matet në mënyra të ndryshme, përmes metodës së ftohjes së brendshme ose me metodën e ngrohjes së jashtme. Në të dy rastet, trupi i boshatisur duhet të vihet në një dhomë të izoluar.

8. Çfarëdo metode të aplikohet, temperatura mesatare e dhomës së izoluar gjatë gjithë kohës së testimit duhet të mbahet uniforme dhe konstante brenda intervalit $\pm 0.5^\circ\text{C}$, në një nivel të tillë që diferenca e temperaturës midis brendësisë së pajisjes dhe dhomës së izoluar është $25^\circ\text{C} \pm 2^\circ\text{C}$, temperatura mesatare e mureve të trupit duhet të mbulohet në nivelet $+20^\circ\text{C} \pm 0.5^\circ\text{C}$.

Për një periudhë prej një viti pasi ky amendament të hyjë në fuqi¹, stacionet testuese të njohura zyrtarisht duhet të rregullohen me llogaritjen e vlerës mesatare të mureve prej $+20^\circ\text{C}$.

9. Kur koeficienti i përgjithshëm i transmetimit të nxehtësisë (koeficienti K) është përcaktuar përmes metodës me ftohje të brendshme, pika “e lagies” në strukturën e dhomës së izoluar duhet të ndahet në një vlerë prej $+25^\circ\text{C} \pm 2^\circ\text{C}$.

¹ Kjo datë e hyrjes në fuqi është 22 shkurt 1996

Gjatë testit, qoftë me metodën me ftohje të brendshme, qoftë me metodën me ngrohje të brendshme, atmosfera e dhomës duhet të qarkullohet vazhdimisht në mënyrë që shpejtësia e lëvizjes së ajrit 10 cm nga muret të mbahet në vlerat midis 1 dhe 2 metër/sekondë.

10. Kur është aplikuar metoda me ftohje të brendshme, një ose më shumë shkëmbyes nxehtësie duhet të vihen brenda trupit.

Sipërfaqja e këtyre shkëmbyesve duhet të jetë e tillë që, në qoftë se një lëng në një temperaturë jo më të ulët se $0\text{ }^{\circ}\text{C}$ ¹ të kalojë përmes tyre, temperatura mesatare e brendshme e trupit të ngelet nën temperaturën $+10\text{ }^{\circ}\text{C}$ gjatë kryerjes së veprimeve të vazhdueshme, ku është aplikuar metoda me ngrohje elektrike (rezistencat apo sende të ngjashme si ato) duhet të vihen në përdorim.

Shkëmbyesit e nxehtësisë ose pajisjet ngrohëse elektrike duhet të përshtaten me një shfryrës ajri që të ketë një shpejtësi shpërndarëse të mjaftueshme për të arritur 40 deri 70 ngarkesë ajri për orë në varësi të vëllimit të zbrazur të trupit testues, dhe shpërndarja e ajrit rreth të gjitha sipërfaqeve të trupit të testuar duhet të jetë e mjaftueshme që për të siguruar maksimumin e diferencës midis temperaturave, çdo pikë 2 dhe 12 të përcaktuara në pikën 3 të kësaj shtojce të mos kalojë 3°C kur funksionimi i vazhdueshëm ka nisur.

11. Instrumentet matëse të temperaturës të mbrojtura nga rrezatimi duhet të vihen brenda dhe jashtë trupit në pikat e specifikuar 3 dhe 4 të kësaj shtojce.

12. Pajisjet për prodhimin dhe shpërndarjen e ngrohtësisë apo të ftohtësisë, dhe ato për matjen e sasisë së ngrohjes apo ftohjes dhe ekuivalenti i nxehtësisë së ventilatorëve ajër-qarkullues duhet të vihen në funksionim.

Humbjet e kabllit elektrik midis nxehtësisë hyrëse të instrumentit matës dhe trupit të testuar duhet të ndreqet nga një matje ose llogaritje dhe të zbritet nga nxehtësia e përgjithshme hyrëse e matur.

13. Kur funksionimi i vazhdueshëm është ndrequr, diferenca maksimale midis temperaturave në pikat më të ngrohta dhe të ftohta në pjesën e jashtme të trupit s' duhet të kalojnë $2\text{ }^{\circ}\text{C}$.

14. Temperatura mesatare e brendshme dhe ajo e jashtme e trupit duhet që secila të lexohet jo më pak se 4 herë në orë.

15. Testi duhet të vazhdohet aq gjatë sa ç'është e nevojshme për t'u siguruar që funksionimi është i vazhdueshëm (shih pikën 6 në këtë shtojcë).

Në qoftë se jo të gjithë matësit janë automatikë dhe të regjistruar, testi duhet të vazhdohet për një periudhë prej 8 orësh në vazhdim për t'u siguruar që funksionimi është i vazhdueshëm dhe për të marrë leximet përfundimtare.

b) Kontenierët me lëndë ushqimore të lëngshme.

16. Metoda e përshkruar më sipër aplikohet vetëm në një pajisje konteiner njëdhomëshe apo shumëdhomëshe, i destinuar vetëm për transport të ushqimeve të tilla si qumështi.

Çdo ndarje e të tillë konteinerëve duhet të ketë të paktën një-hapje kryesore—derë e pasme e konteinerit dhe një tub shkarkimi të lidhur me folenë e brendshme; aty ku ka disa dhoma ndarëse ato duhet të ndahen njëra nga tjetra nëpërmjet pjesëve jo të izoluara të vëna vertikalisht.

17. Kapaciteti izolues duhet të testohet gjatë operimit të vazhdueshëm përmes ngrohjes së brendshme të konteinerit bosh në një dhomë të izoluar.

18. Nëpërmjet testit, temperatura mesatare e dhomës së izoluar duhet të mbahet uniforme dhe konstante brenda intervalit $\pm 0.5\text{ }^{\circ}\text{C}$, në një nivel të tillë që diferenca e në temperaturë midis brendësisë së pajisjes dhe dhomës së izoluar të jetë jo më pak se $25\text{ }^{\circ}\text{C} \pm 2\text{ }^{\circ}\text{C}$, me temperaturë mesatare të mureve të trupit të mbajtura në nivelet $+20\text{ }^{\circ}\text{C} \pm 0.5\text{ }^{\circ}\text{C}$.

Për një periudhë prej një viti pas hyrjes në fuqi² të këtij amendamenti, stacionet testuese zyrtarisht të njohura mund të rregullojnë në llogaritjen e vlerave të matura të koeficientit K, dhe ta mbajnë në një temperaturë mesatare mureve prej $+20\text{ }^{\circ}\text{C}$.

19. Atmosfera e dhomës duhet të qarkullojë vazhdimisht në mënyrë që shpejtësia e lëvizjes së ajrit, 10 cm larg nga muret, të jetë midis 1 dhe 2 m/sek.

20. Një shkëmbyes nxehtësie duhet të vihet brenda rezervuarit. Në qoftë se rezervuari ka disa ndarje, një shkëmbyes nxehtësie duhet të vihet në secilën nga ndarjet.

¹ Të parandalohet ngricen.

² Data e hyrjes së saj në fuqi është 22 shkurt 1996.

Shkëmbyesit duhet të jenë të pajisur me rezistorë elektrikë dhe një helikë me shpejtësi të atillë që të sigurojë se diferenca midis temperaturës maksimale dhe temperaturës minimale brenda secilës ndarje të mos e kalojë 3°C gjatë punës së vazhdueshme.

Nëse kontenieri përmban disa ndarje, diferenca midis temperaturës mesatare në ndarjen më të ftohtë dhe temperaturës mesatare në ndarjen më të ngrohtë nuk duhet t'i kalojë 2°C , sipas temperaturave të përcaktuara në pikën 21 të kësaj shtojce.

21. Instrumentet matëse të temperaturës të mbrojtura nga rrezatimi, duhet të vihen në brendësi dhe jashtë kontenierit 10 cm larg nga muret, siç është përshkruar më poshtë:

a) Në qoftë se kontenieri ka vetëm një ndarje, matjet duhet të bëhen minimumi në 12 pika, pozicionuar si më poshtë:

- Katër skajet e dy diametrave të këndeve të drejta të njëri-tjetrit, njëri horizontal dhe tjetri vertikal, pranë secilës prej dy fundeve të kontenierit.

- Katër skajet e dy diametrave të këndet e drejta të njëri-tjetrit, i pjerrët te një kënd 45° te horizontali, në planin boshtor të kontenierit.

b) Në qoftë se kontenieri ka vetëm disa ndarje, pikat e matjes duhet të jenë si më poshtë:

për çdo dy kompartimente fundore, të paktën si vijon:

Skajet e diametrit horizontal afër fundit të skajeve të diametrit vertikal pranë ndarjes dhe për çdo ndarje tjetër, të paktën si vijon:

Skajet e diametrit të pjerrët në një kënd 45° te horizontali pranë njërës nga të ndarat dhe skajet e diametrit pingul te e para dhe pranë ndarjes tjetër.

Temperatura mesatare e brendshme dhe temperatura mesatare e jashtme duhet të jenë respektivisht mesatarja aritmetike e të gjitha matjeve të marra në brendësi dhe e të gjitha matjeve të marra jashtë kontenierit.

Në rastin e një kontenieri i cili ka disa dhoma, temperatura e brendshme mesatare e çdo ndarjeje duhet të jetë mesatarja aritmetike e matjeve, të numëruar jo më pak se katër, në varësi të çdo ndarjeje.

22. Për pajisjet për ngrohjet dhe qarkullim ajri edhe për matjen e sasisë së nxehtësisë së shkëmbyer duhet që të vihen në punë helikat e qarkullimit të ajrit.

23. Kur puna e pajisjeve ka filluar, maksimumi i diferencës ndërmjet temperaturave në pikat më të ngrohta dhe të ftohta në pjesën e jashtme të kontenierit s' duhet të tejkalojnë 2°C .

24. Temperatura mesatare e jashtme dhe temperatura mesatare e brendshme e kontenierit duhet që secila të lexohet jo më pak se katër herë në orë.

25. Testi duhet të vazhdohet për aq gjatë sa ç'është e nevojshme për të siguruar një punë të vazhdueshme (shih pikën 6 në këtë shtojcë).

Në qoftë se të gjitha matjet janë automatike dhe të regjistruara testi duhet të vazhdohet për një periudhë prej tetë orësh në vazhdim për të qenë të sigurt për funksionin e vazhdueshëm dhe për të siguruar lexime përfundimtare.

c) Klauzolat e përbashkëta për të gjitha llojet e pajisjes së izoluar.

I. Verifikimi i koeficientit K

26. Aty ku qëllimi i testeve nuk është përcaktimi i koeficientit K, por thjesht verifikimi që ai është nën një kufi të caktuar, testet e kryera sipas pikave nga 7 deri në 25 të kësaj shtojce mund të ndërpriten menjëherë pasi madhësitë e bëra tregojnë se koeficienti K plotëson kushtet e vëna për të.

II. Saktësia e matjeve të koeficientit K

27. Vendet ku kryhen testet duhet të pajisen me instrumentet e nevojshme për të siguruar se koeficienti K është kushtëzuar me një kufi maksimal të gabimit prej $\pm 10\%$, kur përdoret metoda e ftohjes së brendshme dhe $\pm 5\%$ kur përdoret metoda e ngrohjes së brendshme.

III. Raportet e testit

28. Një raport testi përbëhet nga:

Pjesa 1 sipas modelit nr.1 A ose 1 B poshtë;

Pjesa 2 sipas modelit nr.2 A ose 2 B poshtë dhe duhet të jetë e përpiluar për çdo testim të një materiali të pajisjes.

Kontrolli i kapacitetit izolues të pajisjes në shërbim.

29. Për qëllimin e kontrollit të kapacitetit izolues të çdo pjese të pajisjes në punë siç paraqitet në shtojcën 1, pikat 1 (b) dhe 1 (c) të këtij aneksi, autoritetet përgjegjëse mundet:

- Të zbatojnë metodat e përshkruara në pikat 7 deri 27 të kësaj shtojce;

- Të caktojnë ekspertë të cilët të asistojnë në mbajtjen konform kategorive të pajisjes së izoluar. Këto ekspertë duhet të ndjekin veçantitë e mëposhtme në llogari dhe duhet t'i mbështesin përfundimet e tyre në kriteret e vendosura më parë.

a) Shqyrtimi i përgjithshëm i pajisjes.

Ky shqyrtim duhet të ketë formën e një inspektimi të pajisjes për të përcaktuar hapat e mëposhtme:

- I. projekti i përgjithshëm i izoluesit;
- II. metoda e zbatimit të izolimit;
- III. natyra dhe kushtet e mureve;
- IV. kushtet e kompartimentit izolues;
- V. trashësia e mureve;

dhe të bëjë të gjitha vëzhgimet e nevojshme përta i përket kapacitetit izolues të pajisjes. Për këtë qëllim ekspertët mund të bëjnë pjesë të pajisjes për t'u çmontuar dhe kërkojnë të gjitha dokumentet që ata mund të kenë nevojë për t'u konsultuar (plane, raporte testimesh, hollësi, fatura etj.) t'u vihen në dispozicion.

b) Ekzaminimi për shtypjen e ajrit (jo e zbatueshme tek pajisjet konteniere)

Inspektimi duhet të bëhet nga një vëzhgues i vendosur brenda pajisjes, i cili duhet të vihet në një sipërfaqe të ndriçuar.

Çdo metodë që përfton rezultate më të sakta mund të përdoret.

c) Vendime.

I. Në qoftë se përfundimet përta u përket kushteve të përgjithshme të trupit janë të favorshme, pajisja mund të mbahet në punë si pajisje izoluese e klasit të saj fillestar për një periudhë prej më tepër se tre vjet.

Në qoftë se përfundimet e ekspertit ose të ekspertëve janë të pafavorshme, pajisja mund të mbahet në shërbim vetëm nëse kalon në një stacion testues, sipas testeve të vendosura në pikat 7 deri në 27 të kësaj shtojce; ajo mund të mbahet në shërbim për një periudhë të mirë për gjashtë vjet.

II. Në qoftë se pajisja përbëhet nga njësi të pajisjeve të prodhuara në seri të një tipi të veçantë, duke plotësuar kërkesat e shtojcës 1, pika 2 të këtij aneksi dhe në qoftë se i përket një pronari, atëherë në shtesë të inspektimit të çdo njësie të pajisjes me koeficient K jo më pak se 1% të numrit të njësive mund të matet në përputhje me parashikimet e paragrafëve 7 deri në 27 të kësaj shtojce.

Në qoftë se rezultatet e ekzaminimeve edhe matjeve janë të favorshme, të gjitha pajisjet në fjalë mund të mbahen në shërbim si pajisje izoluese të klasit të tyre fillestar për një periudhë më tepër se 6 vjet.

d) Të dhënat e testimit.

Një raport testimi përbëhet nga:

Pjesa 1 në përputhje me modelin nr.1 A më poshtë;

Pjesa 2 në përputhje me modelin nr. 3 poshtë dhe duhet të jetë përpiluar për çdo testim një material të pajisjes nga një ekspert.

Përgatitje transite dhe të zbatueshme për një pajisje të re.

30. Për katër vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me parashikimet e nenit 11, pika 1, në qoftë se hasen shmangie nga stacionet testuese, koeficienti K i pajisjes nuk mund të matet nga procedurat e dhëna në pikat 7 deri 27 të kësaj shtojce, në pajtim me pajisjen e re izoluese me standardet e përshkruara në këtë aneks, mund të verifikohet me zbatimin e klauzolave të pikës 29 dhe, përveç, llogaritjes së kapacitetit izolues se në dritën e gjykimit pasues.

Materiali izolues i përbërësve kryesorë (muret anësore, tavani, dyshemeja, dyert etj.) të pajisjes duhet të ketë një trashësi uniforme duke e tejkaluar në terma të gjatësisë gjeometrike të përftuar nga ndarja e koeficientit të konduktivitetit termik të materialit në një mjedis të lagësht nga koeficienti K i kërkuar për kategorinë në të cilën përfshirja e pajisjes kërkohet.

C. Efektshmëria e veglave ndihmëse të pajisjes.

Procedurat për të caktuar efektshmërinë e veglave termike të pajisjes.

31. Procedurat për caktimin e mjeteve ndihmëse të pajisjes duhet të përcaktohen nga metodat e përshkruara në pikat 32 deri në 47 të kësaj shtojce.

Pajisja ftohëse

32. Pajisja e boshatisur duhet të vihet në një dhomë të izoluar ku temperatura mesatare duhet

të mbahet uniforme dhe konstante brenda $\pm 0.5\text{ }^{\circ}\text{C}$, në $+ 30\text{ }^{\circ}\text{C}$. Atmosfera e dhomës, e cila duhet të mbahet me lagështirë, duke rregulluar temperaturën midis $+ 25\text{ }^{\circ}\text{C} \pm 2\text{ }^{\circ}\text{C}$, duhet të qarkullojë siç është përshkruar në pikën 9 të kësaj shtojce.

33. Instrumentet matëse të temperaturës të mbrojtur kundrejt rrezatimit duhet të vihen brenda dhe jashtë trupit në pikat e përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 të kësaj shtojce.

34. a) Në rastin e një pajisjeje të ndryshme nga ajo me pllaka eutetike të fiksuara dhe nga ajo pajisje e përshtatur me sisteme gazi të lëngshëm, pesha maksimale e ftohësit të përcaktuara nga prodhuesi, e cila normalisht mund të përshtatet, duhet të vihet në hapësirat e duhura ku temperatura mesatare e brendshme e trupit të ketë arritur temperaturën mesatare të jashtme të trupit ($+ 30\text{ }^{\circ}\text{C}$).

Dyert, hapjet kryesore dhe të tjera duhet të mbyllën dhe pajisjet ventiluese të brendshme (në qoftë se ka) të pajisjes duhet të punojnë në maksimumin e kapacitetit.

Në rast të një pajisjeje të re, pajisja ngrohëse me një kapacitet ngrohës të barabartë me 35 % të nxehtësisë së shkëmbyer përmes mureve, në punën e përditshme, duhet të punojnë në brendësi të trupit kur temperatura e përshkruar për çdo klasë të cilës mendohet se pajisja i përket është arritur. Nuk duhet shtuar tjetër ftohës gjatë testimit.

c) Në rast të një pajisjeje me pllaka të ngulura eutetike gjatë testimit duhet të ushtrojnë një fazë paraprake të ftohjes së tretësirës eutetike.

Për këtë qëllim, kur temperatura mesatare e brendshme e trupit dhe temperatura e pllakave kanë arritur temperaturën mesatare të jashtme ($+ 30\text{ }^{\circ}\text{C}$), pajisja pllakëftohëse duhet të hyjë në punë për 18 orë në vazhdim pas mbylljes së dyerve dhe hapjeve të tyre.

Në qoftë se pajisja pllakëftohëse përfshin një mekanizëm që punon me cikle, kohëzgjatja totale e punës së pajisjes duhet të jetë 24 orë.

Në rastin e një pajisjeje të re, menjëherë sapo pajisja ftohëse të ndalet, një pajisje ngrohëse me kapacitet ngrohës e barabartë të 35 % të nxehtësisë së shkëmbyer përmes mureve gjatë funksionimit të pajisjes do të ndizet brenda trupit ku temperatura e dhënë për klasin së cilës pajisja mendohet se i përket është arritur. Solucionin nuk duhet të ngrohet gjatë testimit.

d) Në rastin e pajisjes së përbërë me sisteme gazi të lëngëzuar, procedura e mëposhtme e testimit duhet përdorur: kur temperatura mesatare e brendshme e trupit ka arritur temperaturën mesatare të jashtme ($+30^{\circ}\text{C}$), mbajtësit për gazin e lëngëzuar duhet të mbushen në një nivel të përshkruar nga prodhuesi.

Më pas, dyert dhe hapjet e tjera duhet të mbyllën si në një funksionim normal dhe pajisjet e brendshme të ventilimit duhet të ndizen në maksimumin e kapacitetit të tyre.

Termostati duhet të zgjidhet në një temperaturë jo më tepër se 2 gradë nën temperaturën kufi të klasit që mendohet se pajisjes i takon. Ftohja e trupit duhet të fillojë menjëherë gjatë ftohjes së trupit, ftohësi i konsumuar zëvendësohet sërish, ky zëvendësim duhet të përmbushet:

Ose për një kohë korresponduese e intervalit midis fillimit të ftohjes dhe momentit ku temperatura e përcaktuar për klasin që pajisja mendohet se i përket është arritur për herë të parë;

Ose për një kohëzgjatje prej tre orësh duke filluar që nga fillimi i ftohjes, që sidoqoftë është më e shkurtër.

Pas kësaj periudhe, asnjë ftohës shtesë nuk duhet të ngarkohet gjatë testimit.

Në rast të një pajisjeje të re, një pajisje ngrohëse me kapacitet ngrohës e barabartë me 35% të nxehtësisë së shkëmbyer përmes mureve gjatë punës duhet të vihet në punë brenda trupit ku temperatura e klasit të vendosur është arritur më parë.

35. Temperatura mesatare e brendshme dhe temperatura mesatare e jashtme e trupit duhet që secila të lexohet jo më pak se njëherë çdo 30 min.

Testimi duhet të vazhdohet për 12 orë pasi temperatura mesatare e brendshme të ketë arritur kufirin më të ulët të përcaktuar në varësi të klasit që pajisja mendohet se i përket (A = $+7^{\circ}\text{C}$; B = -10°C ; C = -20°C ; D = 0°C) ose, në rast të një pajisjeje me pllaka të fiksuara eutetike, pas ndalimit të pajisjes ftohëse.

36. Testimi duhet të rezultojë i kënaqshëm, në qoftë se temperatura mesatare e brendshme e trupit nuk e kalon kufirin më të ulët të përcaktuar më sipër gjatë një periudhe prej 12 orësh.

Pajisjet ftohëse mekanike

37. Testimi duhet të përmbajë të gjitha kushtet e përshkruara në pikat 32 dhe 33 të kësaj shtojce.

38. Kur temperatura mesatare e brendshme e trupit arrin temperaturën e jashtme ($+30^{\circ}\text{C}$),

dyert dhe të hapurat e tjera duhet të mbyllën dhe si pajisja ftohëse dhe ajo e ventilimit të brendshëm (në qoftë se ka) duhet të vihen në punë në maksimumin e kapacitetit.

Në rastin e një pajisjeje të re, një pajisje ngrohëse me kapacitet ngrohës e barabartë me 35 % e nxehtësisë së shkëmbyer përmes mureve në punë e sipër duhet të vihet në punë në brendësi të trupit kur temperatura e përcaktuar për klasin që pajisja mendohet se i përket është arritur.

39. Temperatura mesatare e brendshme dhe temperatura mesatare e jashtme e trupit duhet që secila të lexohet jo më pak se njëherë në çdo 30 min.

40. Testimi duhet të vazhdohet për 12 orë pasi temperatura mesatare e brendshme e trupit ka arritur:

ose kufirin më të ulët të dhënë për çdo klasë së cilës pajisja mendohet se i përket në rastin e klasit A, B dhe C ($A = 0\text{ }^{\circ}\text{C}$; $B = -10\text{ }^{\circ}\text{C}$; $C = -20\text{ }^{\circ}\text{C}$); ose

një nivel jo më të ulët se kufiri i sipërm i dhënë për çdo klasë së cilës pajisja mendohet se i përket në rastin e klasit D, E dhe F ($D = 0\text{ }^{\circ}\text{C}$; $E = -10\text{ }^{\circ}\text{C}$; $F = -20\text{ }^{\circ}\text{C}$).

Testimi duhet të jetë i kënaqshëm, në qoftë se pajisja ftohëse është në gjendje të mbajë kushtet e përshkruara të temperaturës gjatë periodave të thëna 12 orëshe, (në qoftë se ka) të shkrijës automatike të njësishë ftohëse pa e marrë parasysh.

41. Në qoftë se pajisja ftohëse me të tërë përbërësit e saj ka pësuar çmontim, për të kënaqur autoritetin përgjegjës, një testim për të caktuar kapacitetin efektiv ftohës në temperaturat e dhëna, pajisja e transportit mund të pranohet si ftohës mekanik pa pësuar një test rendimenti, në qoftë se kapaciteti ftohës efektiv i pajisjes në operimin vazhdues tejkalon humbjen e nxehtësisë përmes mureve për klasin nën konsideratë, shumëzuar me faktorin 1.75.

42. Në qoftë se njësia ftohëse mekanike është zëvendësuar me njësinë e një tipi të ndryshëm, autoriteti përgjegjës mundet:

a) të kërkojë që pajisja t'i nënshtrohet përcaktimeve dhe verifikimeve të përshkruara në pikat 37 deri 40;

b) të plotësojë vetë dhe të provojë se kapaciteti efektiv ftohës i njësishë së re ftohëse mekanike është te temperatura e përshkruar për pajisjen e klasit që i përket, të paktën e njëjlojtë me njësinë e zëvendësuar;

c) të plotësojë vetë se kapaciteti efektiv ftohës i njësishë së re mekanike ftohëse plotëson kërkesat e pikës 41.

Pajisjet nxehtëse

43. Pajisja bosh do të vihet në një dhomë të izoluar, temperatura e së cilës duhet të mbetet uniforme dhe konstante në një nivel sa më të ulët që të jetë e mundur. Atmosfera e dhomës duhet të qarkullohet siç përshkruhet në pikën 9 të kësaj shtojce.

44. Instrumentet matëse të temperaturës së ruajtur nga rrezatimi duhet të vihen brenda dhe jashtë trupit në pikat e përcaktuara sipas pikave 3 dhe 4 të kësaj shtojce.

45. Dyert dhe hapjet e tjera duhet të jenë të mbyllura dhe pajisja ngrohëse dhe ventilatorët e brendshëm (në qoftë se ka) duhet të ndizen në një kapacitet maksimal.

46. Temperatura mesatare e jashtme dhe temperatura mesatare e brendshme e trupit duhet që secila të lexohet jo më pak se njëherë çdo 30 min.

47. Testimi duhet të vazhdohet për 12 orë, pasi diferenca midis temperaturës së brendshme dhe të jashtme të trupit ka arritur nivelet e përcaktuara për secilën nga klaset që mendohet se i përket pajisja, duke arritur në 35 % në rast të përdorimit të një pajisjeje të re. Testimi do të jetë i kënaqshëm nëse pajisja ngrohëse është në gjendje të mbajë diferencën e caktuar të temperaturës gjatë 12 orëve në vazhdim.

Të dhënat e testimit

48. Një raport testimi përmban:

- Pjesa 1 në përputhje me modelin nr. 1 A ose 1 B si më poshtë; në qoftë se ky nuk është i përgatitur për një testim siç përshkruhet në pikën 28;

- Pjesa 3 në përputhje me modelin nr. 4 A, 4 B, 4 C, 5 ose 6 si më poshtë duhet të përpilohet për çdo testim të ndonjë pjese të pajisjes.

Verifikimi i efektshmërisë së pajisjeve termike në shërbim

49. Për të verifikuar, siç përshkruhet në shtojcën 1, pika 1 (b) dhe 1 (c) të këtij aneksi, efektshmërinë e pajisjes termike të çdo ftohësi mekanik apo pajisjeje të nxehtë në shërbim, autoriteti përgjegjës mundet:

- të zbatojë metodat e dhëna në pikat 32 deri në 47 të kësaj shtojce;
- të caktojë ekspertë për të ushtruar parashikimet e mëposhtme:

a) Një pajisje ftohëse e ndryshme nga pajisja me akumulatore të palëvizshëm eutetike

Duhet të verifikohet se temperatura e brendshme e pajisjes boshe, e sjellë më parë nga temperatura e jashtme, mund të sillet në kufirin e temperaturës së klasit të cilit pajisja i përket, si e përshkruar në këtë aneks dhe të mbahet nën kufirin e temperaturës për një periudhë të tillë që $t \geq (12 \cdot \Delta \cdot \theta) / (\theta' \cdot \Delta)$ ku $\Delta \cdot \theta$ është diferenca midis + 30 °C dhe temperaturës kufi, dhe $\Delta \cdot \theta'$ është diferenca midis temperaturës mesatare të jashtme gjatë testimit dhe temperaturës së mësipërme kufi, ku temperatura e jashtme nuk duhet të jetë më e ulët se + 15 °C, në qoftë se përfundimet janë të favorshme, pajisja mund të mbahet si pajisje ngrohëse e klasit fillestar për një periudhë jo më tepër se 3 vjet.

b) Pajisja ftohëse mekanike

Duhet të verifikohet se temperatura e jashtme nuk është më e ulët se + 15 °C dhe temperatura e brendshme e pajisjes boshe, e cila ka arritur përafërsisht në temperaturën e jashtme, mund të arrijë në një periudhë prej 6 orësh:

Në rastin e pajisjes së klasit A, B ose C, temperatura më e ulët, siç u përshkrua në këtë aneks;

- Në rastin e pajisjes së klasit D, E ose F, temperatura kufi, siç u përshkrua në këtë aneks;

- Në qoftë se përfundimet janë të favorshme, pajisja mund të mbahet në punë si ftohës mekanik të klasit të saj fillestar për një periudhë tjetër, por jo më shumë se tre vjet.

c) Pajisja ngrohëse

Duhet të verifikohet se diferenca midis temperaturës së jashtme të pajisjes dhe temperaturës së brendshme për klasin, së cilës pajisja i përket siç u përshkrua në këtë aneks (një diferencë prej 22 °C në rastin e klasit A dhe 32 °C në rastin e klasit B) mund të arrihet dhe mbahet për jo më pak se 12 orë.

Në qoftë se përfundimet janë të favorshme, pajisja mund të qëndrojë në funksionim si pajisje ngrohëse të klasit të saj fillestar për një periudhë të mëtejshme jo më shumë se tre vjeçare.

d) Klauzolat e përbashkëta të pajisjet ftohëse, mekanike ftohëse dhe ngrohëse

I. Në qoftë se përfundimet janë të pafavorshme, pajisjet ftohëse, mekanike ftohëse apo ngrohëse duhet të mbahen në funksionim nën klasin e saj fillestar, vetëm nëse kalon në një stacion provues testimet e përshkruara në pikat 32 deri në 47 të kësaj shtojce, mundet që pas kësaj të mbahet në funksionim në klasin e saj fillestar për një periudhë 6-vjeçare.

II. Në qoftë se pajisja përbëhet nga njësi të prodhuara në seri qofshin këto ftohës apo ngrohës, të cilat plotësojnë kërkesat e shtojcës 1, pika 2 të këtij aneksi, atëherë për çdo njësi duhet të përcaktohen kushte të tilla që efektshmëria i ftohësit apo ngrohësit të jetë jo më pak se 1 % e numrit të njësisve që mund të testohen në një stacion testues në përputhje me parashikimet në pikat 32 deri në 47 të kësaj shtojce.

Në qoftë se përfundimet e kontrollit dhe e përcaktimit të efektshmërisë janë të kënaqshme, e tërë pajisja në fjalë mund të mbahet në shërbim në klasin e saj fillestar për një periudhë tjetër 6-vjeçare.

e) Të dhënat e testimit

Një raport testimi përmban:

- Pjesën 1 të modelit nr.1 A poshtë, në qoftë se kjo s'është tashmë e përgatitur për një të dhënë testimi sipas pikës 29 (d);

- Pjesën 3 të modelit nr.7, 8 ose 9 poshtë, duhet të përpilohet për çdo testim të ndonjë pjese të pajisjes nga një ekspert.

Klauzolat kalimtare të zbatueshme të pajisja e re

50. Për 4 vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me parashikimet e nenit 11, pika 1, nëse ka shmangie nga stacionet testuese, rendimenti i mjeteve teknike të pajisjes nuk mund të përcaktohet nga procedurat e dhëna në pikat 32 deri në 47 të kësaj shtojce, përshtatshmëria e pajisjes ftohëse, ngrohëse mund të verifikohet nëse është brenda standardeve, duke zbatuar përgatitjet e pikës 49 të kësaj shtojce.

D. Procedurat për matjen e kapacitetit ftohës efektiv W0 të një njësie kur avulluesi nuk ka ndalesa nga ngrirja.

51. Në çdo temperaturë ekuilibri, ky kapacitet është i barabartë me shumën e rrymës së nxehtësisë $U \cdot \Delta \theta$ që lëshohet nga muret e kutisë matëse të nxehtësisë së pajisjes transportuese, së cilës i është bashkëngjitur njësia ftohëse dhe njësia ngrohëse e ventilatorit që sjell një fuqi ngrohëse W_j në brendësi të trupit që është:

$$W_0 = W_j + U \cdot \Delta \theta$$

52. Njësia ftohëse është përshtatur ose në një kuti nxehtësie, ose në një njësi transporti. Në secilin nga rastet, nxehtësia e përgjithshme e transmetuar matet në një pikë të vetme të murit, ku temperatura është mesatare në varësi të kapacitetit të testimit.

Një faktor aritmetik rregullues, i bazuar në përvojën e vendit testues, merret në konsideratë për të llogaritur temperaturën mesatare të mureve në secilin nga ekuilibret termike gjatë përcaktimit të kapacitetit efektiv ftohës.

Është e nevojshme të përdoret një kuti e kalibruar nxehtësimatëse për të marrë një maksimum nxehtësie.

Matjet dhe procedura duhet të jenë siç janë përshkruar në pikat 1 deri në 15 sipër, sidoqoftë është e mjaftueshme për të matur U -në drejtpërdrejt, vlera e këtij koeficienti përcaktohet nga formula:

$$U = W / \theta \Delta m$$

ku:

W fuqia ngrohëse (në watt) e shpërndarë nga ventilatorët dhe ngrohësi i brendshëm;

Δm është diferenca midis temperaturës mesatare të brendshme θ_i dhe temperaturës mesatare të jashtme θ_e ;

U është rryma e ngrohësisë për gradë e diferencës midis temperaturës së ajrit brenda dhe jashtë kutisë ose njësisë nxehtësimatëse të pajisjes transportuese, matur me njësi ftohëse të përshtatshme.

Kutia nxehtësimatëse ose njësia e pajisjes së transportit është vënë në një dhomë testimi. Në qoftë se një kuti nxehtësimatëse është përdorur, $U \cdot \Delta \theta$ nuk duhet të jetë më tepër se 35% e rrymës totale të nxehtësisë W_0 . Kjo kuti nxehtësimatëse duhet izoluar mirë.

53. Metoda e mëposhtme mund, në qoftë se është e nevojshme, të përdoret si për pajisjen dhe për testimin në pajisjet e prodhuara në seri. Në këtë rast, efektiviteti i kapacitetit ftohës matet duke gjetur prodhimin e fluksit të ajrit (m), të ftohësit të lëngshëm dhe differences entalpike midis avujve ftohës që largohen nga njësia ftohëse (h_0) dhe lëngu në hyrje të njësisë (h_i).

Për të përfutur efektivitet në kapacitetin ftohës, fuqia e nxehtësisë prodhuar nga ventilatori (W_f) zbritet. Është e vështirë për të matur W_f , në qoftë se ventilatorët që qarkullojnë ajrin vihen në punë nga një motor i jashtëm, në këtë rast të veçantë rekomandohet përdorimi i metodës entalpike. Kur ventilatorët vihen në punë nga motorë elektrike të brendshëm, fuqia elektrike matet me instrumente të përshtatshme me një saktësi prej $\pm 3 \%$.

Ekuilibri i nxehtësisë jepet nga formula:

$$W_0 = (h_0 - h_i) m - W_f$$

Metodat e përshtatshme janë të përshkruara në standardet ISO 971, BS 3122, DIN, NEN etj. Një ngrohës elektrik vihet në brendësi të pajisjes për të përfutur ekuilibrin termik.

54. Instrumentimi

Vendet testuese duhet të pajisen me instrumentet e duhura për të matur vlerën U të një saktësi prej $\pm 5 \%$. Nxehtësia e larguar përmes rrjedhjes së ajrit nuk duhet të kalojë 5 % të vlerës totale të nxehtësisë së larguar përmes kutisë nxehtësimatëse ose përmes njësisë së pajisjes transportuese.

Matja e rrymës së ftohësit duhet të jetë me një saktësi prej $\pm 5 \%$. Kapaciteti i ftohësit duhet të jetë me një saktësi prej $\pm 10 \%$.

Instrumentet e kutisë nxehtësimatëse ose njësisë së pajisjes transportuese duhet të jetë në përputhje me pikat 3 dhe 4 sipër. Duhet të bëhen këto matje të mëposhtme:

a) Temperaturat e ajrit:

Të paktën katër termometra duhen shpërndarë njëtrajtësisht te hyrja e aparatit të avullimit.

Të paktën katër termometra të shpërndarë njëtrajtësisht në daljen e aparatit të avulluesit.

Të paktën katër termometra të shpërndarë njëtrajtësisht në hyrjen e kondensuesit.

Termometrat duhen të jenë të mbrojtur nga rrezatimi.

b) Konsumimi i energjisë:

Instrumentet për të matur konsumin e energjisë elektrike ose konsumin e karburantit të njësisë ftohëse duhet të jenë siguruar më parë.

c) Shpejtësi e rrotullimit:

Duhet të jenë siguruar më parë instrumente për të matur shpejtësinë e rrotullimit të kompresorëve dhe ventilatorëve ose të bëhet e mundur që këto shpejtësi të llogariten kur përdorimi i instrumenteve është jopraktik.

d) Presioni:

Matësi me saktësi të lartë (saktësi prej $\pm 1\%$) duhet t'i bashkëngjiten kondensatorit, avulluesit dhe hyrjes së kompresorit ku avulluesi është i pajisur me një rregullator presioni.

e) Sasia e nxehtësisë:

Nxehtësia e shpërndarë nga ventilatorët e brendshëm të nxehtësisë me rezistenca elektrike nuk duhet të kalojnë rrymën prej 1 W/cm^2 dhe njësitë ngrohëse duhet të mbrohen nga një veshje e jashtme me emetim të ulët të nxehtësisë.

55. Kushtet e testimeve

i) Faqja e jashtme e kutisë nxehtësi-matëse apo njësia e pajisjes së transportit: temperatura e ajrit në hyrje të kondensatorit duhet të mbahet në një temperaturë $30^\circ \pm 0.5^\circ\text{C}$.

ii) Brenda kutisë nxehtësimatëse ose njësisë së pajisjes së transportit (te hyrja e ajrit në aparatit e avullimit): tre duhet të jenë nivelet e temperaturës ndërmjet -25°C dhe $+12^\circ\text{C}$ në varësi të karakteristikave të njësisë, ku niveli i temperaturës duke qenë të minimumi i përshkruar për klasën e kërkuar nga prodhuesi me një tolerancë $\pm 1^\circ\text{C}$.

Temperatura mesatare e brendshme duhet të mbahet brenda një tolerance prej $\pm 0.5^\circ\text{C}$ gjatë matjes së kapacitetit ftohës, nxehtësia e shpërndarë brenda kutisë nxehtësimatëse ose njësisë së transportit duhet të jetë në një nivel konstant me tolerancë $\pm 1^\circ\text{C}$.

Kur paraqitet një njësi ftohëse për testim, prodhuesi duhet të plotësojë:

- Dokumentet që shoqërojnë njësinë që do të testohet;
- Një dokument teknik që përmban parametrat më të rëndësishme për funksionimin e njësisë, si dhe nivelet e lejueshme të tyre.

- Karakteristikat e serive të pajisjeve të testuara; dhe

- Një përcaktim të metodës se cilat nga format e energjisë duhet të përdoret gjatë testimit.

56. Procedura e testimit

Testimi duhet të ndahet në dy pjesë kryesore, faza ftohëse dhe matja e efektivitetit të kapacitetit ftohës në tre nivele të ndryshme, rritëse të temperaturës.

a) Faza ftohëse; temperatura fillestare e kutisë nxehtësimatëse ose e pajisjes së transportit duhet të jetë brenda intervalit $\pm 3^\circ\text{C}$ të temperaturës së mjedisit. Ajo duhet të ulet në -25°C (ose në minimumin e temperaturës për klasin).

b) Matja e efektivitetit të kapacitetit ftohës, në çdo nivel temperature të brendshme.

Një testim i parë duhet të bëhet, për të paktën katër orë në çdo nivel temperature nën kontrollin e termostatit (të njësisë ngrirëse) për të stabilizuar nxehtësinë e transferuar midis brendësisë dhe pjesës së jashtme të kutisë nxehtësimatëse.

Një testim i dytë duhet të bëhet pa veprimin e termostatit për të përcaktuar maksimumin e fuqisë dalëse për ftohje, fuqinë ngrohëse të ngrohësit të brendshëm të prodhuar në kushte ekuilibri në çdo nivel temperature të përshkruar në pikën 55.

Kohëzgjatja e testimit të dytë duhet të jetë jo më e paktë se katër orë.

Përpara se të ndryshojmë temperaturën nga një nivel në një tjetër, kutia apo njësia duhen të shkrihen në mënyrë normale.

Në qoftë se njësia ftohëse mund të punojë me më shumë se një formë energjie, testimet duhet të përsëriten për secilën nga ato.

Në qoftë se kompresori vihet në punë nga një motor automobili, testimi duhet të bëhet në të dyja shpejtësitë, shpejtësinë minimale dhe në shpejtësinë nominale të rrotullimeve të kompresorit të përcaktuara nga prodhuesi.

Në qoftë se kompresori vihet në punë nga një mjet lëvizës, testimi duhet të bëhet në shpejtësinë nominale të rrotullimeve të kompresorit siç është përcaktuar nga prodhuesi.

E njëjta procedurë duhet të ndiqet për metodën entalpike të përshkruar në pikën 53, por në këtë rast fuqia ngrohëse e shpërndarë nga aparati i avullimit në çdo nivel temperature duhet të matet.

57. Masat parandaluese.

Pasi testimet për efektivitetin e kapacitetit ftohës kryhen me termostatin e njësisë së shkëputur

ftohëse, masat parandaluese të mëposhtme duhen të vëzhgohen:

në qoftë se pajisja ka një sistem injektimi me gaz të nxehtë, ai duhet që gjatë testimit të ç'aktivizohet;

me kontrollet automatike të njësive ngrirëse e cila shkarkon cilindra individuale (të përshtasë fuqinë ftohëse të njësive tek fuqia e disponueshme prej motorit) testimi duhet të zbatohet me numrin e cilindrave të përshtatshëm për temperaturën.

58. Masat kontrolluese

Kontrollet e mëposhtme duhet të kryhen dhe të përdoren metodat e dhëna në testim:

i) sistemi shkrirës dhe termostati janë duke funksionuar korrektësisht;

ii) shpejtësia e qarkullimit të ajrit është ajo e përcaktuar nga prodhuesi;

Në qoftë se fluksi i ajrit të njësive ftohëse është për t'u matur, atëherë përdoren metoda të përshtatshme për matjen e fluksit total. Përdorni një nga metodat ekzistuese dhe të përshtatshme p.sh. BS 848, ISO 5801, AMCA 210-85, DIN 24163, NFE 36101, NF X10.102, DIN 4796 janë të këshilluara;

iii) ftohësi i përdorur për testim është ai i përcaktuar nga testuesi.

59. Kapaciteti i ftohësit për ATP-në është ai që ka lidhje me temperaturën mesatare të brendshme të përcaktuar nga instrumentet matës të përshkruar në pikën 3 sipër, dhe jo e përcaktuar nga termometrat e vëna në hyrjen apo daljen e aparatit të avullimit.

60. Raportet e testimit

Një raport testimi i llojit të përshtatshëm duhet të përputhet me modelin nr.10 më poshtë:

Modeli nr. 1 A

Raport testimi

Përgatitur konform me klauzolat e Marrëveshjes mbi transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe mbi pajisjen speciale të përdorur për një transport të tillë (ATP)

Raporti i testimit nr.

SEKSIONI 1

Specifikimet e pajisjes (pajisje të ndryshme nga konteineret për transportin e ushqimeve të lëngëta)

Vendi apo eksperti i miratuar për testim:¹

Emri.....

Adresa.....

Lloji i pajisjes:²

Marka..... Numër regjistri..... Numri rendor.....

Data e fillimit të shërbimit.....

Ambalazhi³.....kg Vëllimi mbajtës³).....kg

Skeleti:

Marka dhe tipi..... Numri identifikues.....

Prodhuar nga.....

Zotëruar apo operuar nga.....

Paraqitur nga.....

Data e prodhimit.....

Përmasat kryesore:

Ana e jashtme: gjatësi.....m, gjerësi.....m, lartësi.....m

Ana e brendshme: gjatësi.....m, gjerësi.....m, lartësi.....m

¹ Hiqet edhe si e panevojshme (ekspertët e përdorin vetëm në rastet e kryera nën ATP aneksi 1, shtojca, neni 29 apo 49).

² Vagon, kamion, rimorkio, gjysmërimorkio, konteiner etj.

³ Burimi i shtetit për informacionin.

Sipërfaqja e përgjithshme e dyshemesë së trupit.....m²
 Vëllimi i brendshëm i përdorshëm.....m³
 Sipërfaqja e brendshme e përgjithshme Si e trupit.....m²
 Sipërfaqja e jashtme e përgjithshme Se e trupit.....m²
 Sipërfaqja mesatare: $S = \sqrt{(S_i \cdot S_e)}$m²
 Specifikime mbi muret e trupit:¹
 Pjesa e sipërme.....
 Poshtë.....
 Anët.....
 Karakteristika ndërtimore të trupit:²
 Numri,) i dyerve.....
 pozicioni) i hapjeve.....
 dhe përmasat) e të çarave të ngarkesës së akullit.....
 Pajisje shtesë³.....

 Koeficienti K =W/m²

Modeli nr. 1 B

Raport testimi

Përgatitur sipas klauzolave të Marrëveshjes mbi transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe mbi pajisjet speciale të përdorura në transporte të tilla (ATP)

Raport testimi nr.

SEKSIONI 1

Specifikimet e cisternave për transportin e ushqimeve të lëngshme
 Vendi apo ekspert i miratuar për testim:⁴
 Emri.....
 Adresa.....
 Tipi i cisternës:⁵
 Marka..... Numri i regjistrimit..... Numri rendor.....
 Data e fillimit të shërbimit.....
 Ambalazhi⁶..... Vëllimi mbajtës³.....
 Cisterna:
 Marka dhe tipi..... Numri identifikues.....
 Prodhuar nga.....
 Zotëruar apo operuar nga.....
 Paraqitur nga.....
 Data e prodhimit.....
 Përmasat themelore:
 Ana e jashtme: gjatësia e cilindrit.....m, akset e mëdhenj.....m, akset e vegjël.....m
 Ana e brendshme: gjatësia e cilindrit.....m, akset e mëdhenj.....m, akset e vegjël.....m

¹ Natyra dhe trashësia e materialeve që formojnë muret e trupit, nga e brëndshmja tek e jashtma, mënyra e ndërtimit, etj.

² Në qoftë se ndodhen sipërfaqe jo të rregullta, të tregohet sesi, Si dhe Se janë përcaktuar.

³ Shufra mishi, ventilatorë etj.

⁴ Hiqet edhe si e panevojshme (ekspertët e përdorin vetëm në rast të kryera nën ATP aneksi 1, shtojca, neni 29 apo 49).

⁵ Vagon, kamion, rimorkio, gjysmërimorkio, konteiner etj.

⁶ Burim shteti për informacionin.

Vëllimi i brendshëm i përdorshëm.....m³

Vëllimi i brendshëm i çdo pjese.....m³

Sipërfaqja totale e brendshme Si e cisternës.....m²

Sipërfaqja e brendshme e çdo pjese Si1....., Si2.....,m²

Sipërfaqja e jashtme totale Se e cisternës.....m²

Sipërfaqja mesatare e cisternës: $S = \sqrt{(Si \cdot Se)}$m²

Specifikimet e mureve të cisternës:¹

Karakteristikat kryesore të cisternës:².....

Numra, përmasa dhe përshkrim të vendeve të njerëzve.....

.....

Përshkrim i mbuluesve të vendit të njeriut.....

.....

Pajisje

shtesë.....

Modeli nr. 2 A

SEKSIONI 2

Matja në lidhje me ATP, aneksi 1, shtojca 2, pika 7 deri në 15 e koeficientit të përgjithshëm për nxehësinë e pajisjeve të tjera, të ndryshme nga cisternat për ushqimet e lëngëta.

Metoda provuese: freski e brendshme / nxehësi e brendshme³

Data dhe koha e mbylljes së dyerve të pajisjes dhe të hapurave të tjera:.....

Mesataret e përftuara për.....orët e vazhdimësisë së operimit (nga.....a.m./p.m. të.....a.m./p.m.):

a) Temperatura mesatare e jashtme e trupit: $\theta_e = \dots\dots\dots^\circ\text{C} \pm \dots\dots\dots\text{K}$

b) Temperatura mesatare e brendshme e trupit: $\theta_i = \dots\dots\dots^\circ\text{C} \pm \dots\dots\dots\text{K}$

c) Diferenca në mesataren e temperaturës së arritur: $\Delta \theta = \dots\dots\dots\text{K}$

Shtirja e maksimumit të temperaturës:

Trupi i jashtëm.....K

Trupi i brendshëm.....K

Temperatura mesatare e mureve të trupit $(\theta_e + \theta_i) / 2 \dots\dots\dots^\circ\text{C}$

Temperatura operuese e këmbyesit të nxehësisë⁴..... $^\circ\text{C}$

Pika e vesës e temperaturës së jashtme atmosferike gjatë vazhdimësisë së operimit²)..... $^\circ\text{C} \pm \dots\dots\dots\text{K}$

Kohëzgjatja mesatare e provës.....h

Kohëzgjatja e vazhdimësisë së operimit.....h

¹ Natyra dhe trashësia e materialeve që formojnë muret e cisternës, nga e brendshmja tek e jashtmjat, mënyra e ndërtimit etj.

² Në qoftë se ndodhen sipërfaqe jo të rregullta, të tregohet sesi Si dhe Se janë përcaktuar.

³ Hiqet edhe si e panevojshme.

⁴ Vetëm për testimet e freskise brenda.

Fuqia e konsumuar në këmbyesit: W1.....W
 Fuqia e përthithur nga ventilatorët: W2.....W
 Koeficienti i përgjithshëm i kalimit të nxehtësisë llogaritur nga formula:

$$\begin{aligned} \text{Prova e freskisë së brendshme}^1) K &= (W1 - W2) / (S \cdot \Delta \theta) \\ \text{Prova e nxehtësisë së brendshme}^1) K &= (W1 + W2) / (S \cdot \Delta \theta) \\ K &= \dots\dots\dots W / m^2K \end{aligned}$$

Gabimi maksimal i matjes në provën e përdorur.....%

Vërejtjet: ¹

(Të kompletohet vetëm në qoftë se pajisja s'ka mjete termike:)

Sipas përfundimeve të testimit të mësipërm, pajisja mund të pranohet me anën e një dëshmie në përputhje me ATP-në aneksi 1, shtojca 3 e efektshme për një periudhë jo më shumë se gjashtë vjet, me shenjë dalluese IN/IR¹).

Megjithatë, ky raport duhet të jetë i vlefshëm si një dëshmi e llojit të miratuar brenda domethënies së ATP-së në aneksin 1, shtojca 1, pika 2 (a) vetëm për një periudhë jo më shumë se tre vjet, i cili është.....

Përpiluar në:.....

më:

Nëpunësi testues

Modeli nr. 2 B

SEKSIONI 2

Matjet, sipas aneksit 1 ATP, shtojca 2, pikat nga 16 në 25 për koeficientin e përgjithshëm të kalimit të nxehtësisë së cisternës tek ushqimet e lëngëta.

Metoda testuese: nxehtësia e brendshme

Data dhe koha e mbylljes së dymës së pajisjes.....

Vlerat mesatare përftuar për.....orët e vazhdimësisë së operimit
 (nga.....a.m./p.m. të.....a.m./p.m.):

(a) Temperatura mesatare e jashtme e cisternës: $\theta_e = \dots\dots\dots^\circ\text{C} \pm \dots\dots\dots\text{K}$

(b) Temperatura mesatare e brendshme e cisternës:

$\theta_i = (\sum \text{Sin} \cdot \theta_{in}) / \sum \text{Sin} \dots\dots\dots^\circ\text{C} \pm \dots\dots\dots\text{K}$

(c) Diferenca mesatare e temperaturës së arritur: $\Delta \theta \dots\dots\dots\text{K}$

Shtrirja maksimale e temperaturës:

Cisterna e brendshme.....K

Ndarja e çdo ane të brendshme.....K

Cisterna e jashtme.....K

Temperatura mesatare e mureve të cisternës..... $^\circ\text{C}$

Kohëzgjatja e përgjithshme e testimit.....h

Kohëzgjatja e vazhdimësisë së operimit.....h

Fuqia e konsumuar në këmbyesit: W1.....W

Fuqia e përthithur nga ventilatori: W2.....W

Koeficienti i përgjithshëm i kalimit të nxehtësisë llogaritur nga formula:

$$K = (W1 + W2) / (S \cdot \Delta \theta) \quad K = \dots\dots\dots W/m^2K$$

Gabimi maksimal i matjes me testimin e përdorur.....%

¹ Në qoftë se trupi s'është paralelpipedik, vecanërisht pikat në të cilat temperatura e brendshme dhe e jashtme janë matur.

Vërejtje:¹.....

(Të plotësohet vetëm në qoftë se pajisja s'ka vegla termike)

Sipas përfundimeve të testit të mësipërm, pajisja mund të pranohet me anën e një dëshmie në përputhje me aneksin 1 ATP, shtojca 3 e vlefshme për një periudhë jo më shumë se gjashtë vjet, me shenjen dalluese IN/IR.²

Ndonëse, ky raport duhet të jetë i vlefshëm si një dëshmi e tipit të miratuar brenda kuptimit të aneksit 1 ATP, shtojca 1, pika 2 (a) vetëm për një periudhë jo më shumë se trevjeçare, e cila është.....

Përpiluar në:.....

Nëpunësi testues

më:.....

Modeli nr. 3

SEKSIONI 2

Specialisti përkatës kontrollon kapacitetin izolues të pajisjes në përdorim sipas aneksit 1 ATP, shtojca 2, pika 29.

Kontrolli është bazuar mbi raportin testues nr.datuar.....
nxjerrë nga specialisti për vendin e miratuar të provës (emri dhe adresa).....

Kushtet ku bëhet kontroll:

Sipër.....

Muret anësore.....

Muret fundore.....

Poshtë.....

Dyert apo të hapura të tjera.....

Vulosjet.....

Kanalet kulluese dhe pastruese.....

Hermetiku i ajrit.....

koeficienti K i pajisjes kur është e re (e shfaqur në raportin testues të mëparshëm)

.....W/m²K

Vërejtje:.....

Sipas përfundimeve testuese të mësipërme pajisja mund të pranohet me anën e një dëshmie në përputhje me aneksin 1 ATP, shtojca 3 e vlefshme për jo më shumë se tre vjet, me shenjen dalluese IN/IR.³

Përpiluar në.....

më:.....

Nëpunësi testues

¹ Në qoftë se cisterna s'është paralelepiped, vecanërisht në pikat ku temperatura e jashtme dhe e brendshme ishin matur.

² Hiqet edhe si e panevojshme.

³ Hiqet dhe si e panevojshme.

SEKSIONI 3

Përkufizimi i efektshmërisë së aparatëve ftohëse për pajisjen ftohëse duke përdorur akull apo akull të thatë në një vend të miratuar testues në përputhje me aneksin 1 ATP, shtojca 2, pikat 32-36 përveç, 34 (b) dhe (c).

Aplikimi freskues:

